



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS  
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR RROGOZHINË

Nr. 682 Prot.

Rrogozhinë, më 30.11.2022

### **SHPLLJE**

## **E VENDIT TË LIRË PËR NËNDREJTOR TË INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR SHMB GOSË**

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë në zbatim të ligjit 69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit nr.3 datë 09.02.2022 "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", të shkresës së Shkollës së Mesme të Bashkuar Gosë me Nr. 2 Prot, datë 21.11.2022 të administruar në ZVAP Rrogozhinë me Nr.677 Prot, datë 21.11.2022 shpall vendin e lirë të Nëndrejtorit të Institucionit Arsimor Publik të Arsimit Parauniversitar SHMB Gosë, sipas shtojcës nr 1 bashkëlidhur shpalljes:

### **1. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për vendin e lirë për nëndrejtor :**

- a) Të ketë fituar diplomën e ciklit të dytë në fushën e arsimit ose diplomë të njëvlefshme me të, sipas përcaktimeve të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- b) Të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar" me vlerësim jo më pak se "Mirë, në kualifikimin e fundit;
- c) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi ndaj tij;
- d) Të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm pregaditor për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar ose të jetë pranuar për ta kryer atë ;

### **2. Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e nëndrejtorit në IPAP përmban:**

- a) Jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 1 bashkëlidhur udhëzimit nr 3, datë 09.02.2022);
- b) Kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës ;
- c) Kopjen e identitetit të identifikimit (ID);

- d) Tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 4 bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- e) Certifikatën e drejtuesit të IPAP ose vërtetim nga Shkolla e Drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor;
- f) Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- g) Vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- h) Deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimor të IPAP (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshën madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi;

**3. Drejtori aktual i IPAP ose zëvendësuesi i tij vë në dispozicion të secilit prej aplikantëve një kopje të dokumenteve të mëposhtme;**

- a) Planin afatmesëm të shkollës;
- b) Planin vjetor të shkollës të vitit paraardhës;
- c) Raporin vjetor të shkollës të vitit paraardhës;

Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 2, të shkronjës B, nëpërmjet shërbimit postar në IPAP SHMB Gosë jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes së njoftimit të vendit të lirë për nëndrejtor të IAPP në faqen elektronike zyrtare të ZVAP Rrogozhinë.

**1. Data e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit**

Rezultatet e shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitura në dosjen e aplikantëve shpallen brenda 2 (dy) ditëve pune nga mbledhja e Komisionit të Shqyrtimit dhe Vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e nëndrejtorit të IPAP, sipas shtojcave 1 dhe 4. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 (tre) ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.

- 2. Pas përfundimit të afatit sipas pikës 1, listohen aplikantët të cilët kanë dokumentacionin e plotë dhe të saktë dhe vlerësohen me pikë aplikantët e pranuar për nëndrejtor të IPAP sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 5 të këtij udhëzimi brenda 2 (dy) ditëve pune nga listimi i aplikantëve..
- 3. Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankimim me shkrim para komisionit brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e rezultateve. Pas përfundimit të afatit të ankimimeve, brenda 1 (një) dite punë, Komisioni duhet t'i kthejë përgjigje ankimuesve.
- 4. Kryetari i komisionit i dorëzon drejtorit të IPAP dosjet e aplikimit dhe vlerësimin me pikë për 2 (dy) kandidatët me më shumë pikë

5. Drejtori i IPAP brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dorëzimi i plotë të dokumentacionit nga Komisionit brenda datës, mbledh këshillin e mësuesve dhe kërkon pëlqimin e tij për emërimin e nëndrejtorit, duke parashtruar argumentat me shkrim për këtë qëllim.
6. Brenda 3 (tri) ditëve pune nga mbledhja e këshillit të mësuesve për dhënien e pëlqimit të kandidatëve, shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e nëndrejtorit të IPAP .
7. Kandidati jo fitues ka të drejtën e ankimit në ZVAP brenda 3(tri ) ditë pune nga shpallja e kandidatit fitues.
8. ZVAP brenda 3 (tri) ditë punë kthen përgjigje ankesës.
9. Në përfundim të të gjitha fazave të mësipërme drejtori i IPAP bën emërimin e nëndrejtorit të IPAP.

Pas vlerësimit të dosjeve aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë do të kryejnë intervistën e strukturuar për:

**Fusha e njohurive dhe aftësitë në drejtimin e institucionit mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar ;**

- a) Ligji nr.69/2012 "Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,
- b) Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026;
- c) Udhëzimi nr.12, datë 10.06.2021 "Për procedurat e pranimit të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues Për Shqipërinë";
- d) "Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë" me nr 730/1 prot, datë 28.01.2020 të miratuar me Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë"
- e) Udhëzimi nr. 3 datë 09.02.2022 "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar";
- f) Udhëzimi nr 30, datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar", i ndryshuar;
- g) Kontrata Kolektive e punës me nr 6145 prot, datë 05.06.2018
- h) Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë.

**DREJTORI**

**Luan SHESHI**



Adresa: Lagjia Nr.1, Rrogozhinë

Email-i: ZVArrogozhine@arsimi.gov.al

**Shtojca nr 1**

<b>Nr</b>	<b>DRAP</b>	<b>ZVAP</b>	<b>Institucioni Arsimor</b>
1	DURRËS	RROGOZHINË	SHMB Gosë